



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 1950 prot.

Tiranë, më 02.02.2026

Lënda: Bashkëpunim institucional për informimin dhe orientimin e punëkërkuësve drejt procedurave të rekrutimit në Policinë e Burgjeve

KRYETARIT TË BASHKISË VORË
Z. BLERIM SHERA

Vorë

I nderuar zoti Kryetar,

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nisur nga nevojat organike dhe në funksion të garantimit të standardeve të sigurisë dhe shërbimit në institucionet penitenciare, ka shpallur procedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve vakante në shërbimet e sigurisë në sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve.

Në kuadër të kësaj procedure, është shpallur kërkesa për rekrutim të 200 (dyqind) punonjësve të Policisë së Burgjeve të rolit bazë, për Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në nivel kombëtar.

Në këtë kontekst, me qëllim rritjen e informimit publik dhe sigurimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të kandidatëve potencialë, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për:

- Sensibilizimin dhe informimin e punëkërkuësve në territorin tuaj mbi këtë procedure rekrutimi;
- Orientimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore drejt aplikimit;
- Afishimin e njoftimit në ambientet e bashkisë dhe njësive administrative;
- Publikimin e njoftimit në faqet zyrtare dhe rrjetet sociale të institucionit tuaj;
- Bashkëpunimin me zyrat lokale të punësimit dhe strukturat e shërbimit social për shpërndarjen e informacionit.

Dëshirojmë gjithashtu të theksojmë benefitet dhe garancitë për kandidatët e përzgjedhur:

- Pozicioni i punës është i garantuar;
- Të gjithë punonjësit e rinj do të përfitojnë trajnimet e nevojshme profesionale;
- Uniforma e punës sigurohet nga institucioni;
- Transporti drejt IEVP-ve është i garantuar;
- Punonjësit u garantohet siguri i jetës dhe shëndetit për një periudhë trevjeçare;
- U garantohet e drejta për ecuri në karrierë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Adresa: Rr. Zef Serembe, Tiranë

Tel: 00 355 4 6315755 Fax: 00 355 4 22 82 92 website: www.dpbsh.gov.al e-mail: info@dpbsh.gov.al


Afati i dorëzimit të dokumentacionit për kandidatët është deri më datë 03.03.2026, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në njoftimin zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në faqen zyrtare <https://dpbsh.gov.al/>, rubrika “Njoftime punësimi”.

Bashkëpunimi juaj vlerësohet si thelbësor për garantimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe konkurrues, si dhe për krijimin e mundësive reale të punësimit për qytetarët në territorin tuaj.

Duke ju falënderuar paraprakisht për mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

KLEVIS QOSE



Adresa: Rr. Zef Serembe, Tiranë

Tel: 00 355 4 6315755 Fax: 00 355 4 22 82 92 website: www.dpbsh.gov.al e-mail: info@dpbsh.gov.al